



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 487/8 Prot.

Tiranë, më 14.09.2015

V E N D I M

Nr. 94, datë 14.09.2015

**“Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
nisur me urdhrin e verifikimit nr. 487/1, datë 03.07.2015”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Institucionin e Avokatit të Popullit për rastin e punësimit të nëpunëses ***** ,

VËREJ SE:

Në zbatim të urdhrit të verifikimit nr. 487/1 prot., datë 03.07.2015, është nisur verifikimi i procedurës së konkurimit për ngritjen në detyrë për punonjësen e Avokatit të Popullit, *****.

Nga shqyrtimi i akteve të dërguara me shkresën nr. 168/1, datë 13.07.2015, të Avokatit të Popullit, me shkresën nr. 1327/2 prot., datë 03.08.2015, të drejtuesit të Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe me shkresën nr. 3630/1 prot., datë 19.08.2015, të Departamentit të Administratës Publike, rezulton se ***** është emëruar në pozicionin Përgjegjës në Sektorin e Administratës, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në Autoritetin e Mediave Audiovizive me Urdhrin nr. 49, datë 02.03.2015, kategoria e pagës III-a/1.

Pas emërimit në këtë pozicion pune, ***** ka konkuruar përsëri për ngritje në detyrë në një nga pozicionet e lira “Ndihmës-Komisioner” në Institucionin e Avokatit të Popullit të publikuara në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, me shkresën nr. 26/1 prot, datë 28.02.2015. Pas përfundimit të procedurës së konkurimit, kandidatja ***** është shpallur

fituese dhe me Urdhrin nr. 99, datë 27.05.2015, është emëruar në pozicionin “Ndihmës-Komisioner”, në Mekanizmin Kombëtar për Parandalimin e Torturës, pozicion për të cilin kategoria e pagës është II-b.

Nga dokumentacioni i administruar vërehet se procedura e konkurimit për ngritje në detyrë për pozicionin “Ndihmës-Komisioner”, në Mekanizmin Kombëtar për Parandalimin e Torturës është realizuar konform ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.

Në momentin e dorëzimit të dokumentacionit për të qenë kandidatë për vendin vakant, ****

***** ka qenë nëpunës civil në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, që në kuptim të nenit 26, pika 3/b e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përbën një pozicion të një kategorie paraardhëse, në raport me pozicionin e Ndihmës-Komisionerit, si një parakusht për të konkuruar për ngritje në detyrë.

Pretendimi se nëpunësja në fjalë sapo ishte emëruar në pozicionin “Përgjegjëse sektori” në AMA, dhe se nuk kishte përfunduar periudhën e provës dhe për këtë shkak nuk mund të konkuronte për ngritje në detyrë, nuk është i bazuar në ligj. Sipas nenit 24, pika 1 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 143/2014 dhe VKM nr. 243/2015, periudha e provës parashikohet vetëm për ata nëpunës që emërohen për herë të parë në shërbimin civil dhe se nëpunësit civilë të emëruar nëpërmjet procedurës për ngritje në detyrë nuk i nënshtrohen periudhës së provës. Sipas dokumentacionit të administruar, punonjësja ***** është pranuar për herë të parë në shërbimin civil, pas kryerjes së konkurimit, me aktin nr. 2915/6 prot., datë 20.06.2008, në pozicionin Koordinator për Çështjet Juridike të Politikave të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Zhvillimit dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Departamentin e Administratës Publike, në Ministrinë e Brendshme dhe është konfirmuar si nëpunëse civile në këtë pozicion me aktin nr. 1196/1 prot., datë 22.06.2009.

Nga ana tjetër, rezulton se nëpunësja ***** plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret e posaçme të përcaktuara në Vendimin nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, si dhe të publikuara në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit për pozicionet e lira në Institucionin e Avokatit të Popullit.

Konkretisht, rezulton se:

- Nëpunësja ***** është nëpunës civil i konfirmuar me aktin nr. 1196/1 prot., datë 22.06.2009, në pozicionin Koordinator për Çështjet Juridike të Politikave të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Zhvillimit dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Departamentin e Administratës Publike, në Ministrinë e Brendshme, pozicion ky i barazvlefshëm me pozicionin dhe pagën “përgjegjës sektori”.

- Nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi, fakt ky që del nga përmbajtja e shkresës nr. 2830 Prot., datë 11.06.2015, lëshuar nga Departamenti i Administratës Publike dhe gjithashtu ka vlerësim vjetor pozitiv për pozicionin Koordinator.
- Ka mbi 3 (tre) vjet përvojë pune në kategorinë e pagës III-a, pasi në referencë të dokumentacionit të administruar, ***** ka qenë nëpunës civil në pozicionin Koordinator, pranë Departamentit të Administratës Publike nga viti 2008 deri më Janar të vitit 2014, kur për shkak të ristrukturimit të DAP, ka kaluar në pozicionin “specialist”. Sipas shkresës nr. 3630/1 prot., datë 19.08.2015, të Departamentit të Administratës Publike dhe Vendimit nr. 545, datë 11.08.2011, të Këshillit të Ministrave, pozicioni i punës “Koordinator” në Departamentin e Administratës Publike bënte pjesë në klasën e nëpunësve civilë të nivelit të ulët drejtues, me kategori page III-a.

Bazuar në sa më sipër, në analizë të dokumenteve shkresore të administruara dhe legjislacionit në fuqi, informacioni i paraqitur nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, në përmbajtjen e të cilit ngrihen pretendimet për pavlefshmëri të procedurës së konkurimit për ngritje në detyrë për pozicionin “Ndihmës-Komisioner”, në Mekanizmin për Parandalimin e Torturës, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, për nëpunësen ***** rezulton i pasaktë.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenin 16 dhe 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të nisur në bazë të urdhrin të verifikimit nr. 487/1 prot., datë 03.07.2015, “Për verifikimin e procedurës së konkurimit për ngritjen në detyrë për punonjësen e Avokatit të Popullit, ***** ”.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Kryetari i Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe Avokati i Popullit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA